



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRES

**RAPORT MBI MONITORIMIN  
E BUXHETIT TE BASHKISE DURRES  
TE VITIT 2018**

## Permbajtja

<b>I. VESHTRIM I PERGJITHSHEM.....</b>	<b>4</b>
<b>II. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit .....</b>	<b>5</b>
<b>III. Karakteristika kryesore të performancës së shpenzimeve .....</b>	<b>6</b>
<b>Shpenzimet korrente.....</b>	<b>9</b>
<b>Shpenzimet kapitale.....</b>	<b>11</b>
<b>IV. Treguesit financiare per vitin 2018 .....</b>	<b>13</b>
<b>V. Detyrimet e prapambetura .....</b>	<b>14</b>
<b>VI. Fondet e zhvillimit te rajoneve.....</b>	<b>14</b>
<b>Aneks 1. Realizimi te ardhurave per vitin 2018 .....</b>	<b>16</b>
<b>TE ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE.....</b>	<b>20</b>
Taksa mbi Pasurine .....	20
Taksa e Pasurise nga Biznesi .....	22
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel .....	23
Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme. ....	24
Taksa e Mjeteve te perdorura.....	25
Taksa e Tabeles per qellime identifikimi .....	26
Taksa e Tabeles per qellime reklamimi .....	26
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja. ....	27
Taksa e Fjeties ne Hotel.....	28
<b>TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE .....</b>	<b>29</b>
Tarifa e gjelberimit .....	29
Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave.....	30
Tarife e zenies se hapsires publike.....	32
Tarifa e zenies se hapsires publike per treg .....	32
Tarifa e plazheve Private.....	33
Tarifa e parkimit. ....	33
Tarifa e ndricimit .....	34
Tarifa e transportit publik .....	35

Tarifa e shërbimeve administrative.....	35
Tarifa e Urbanistikes .....	35
Te ardhura te tjera .....	35
Te ardhura nga institucionet.....	36
<b><i>Pasqyra e realizimit te ardhurave nga taksat e tarifat vendore per vitin 2018 .....</i></b>	<b>36</b>
<b><i>ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve" .....</i></b>	<b>42</b>
<b><i>ANEKSI nr. 2 "Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikuljeve".....</i></b>	<b>44</b>
<b><i>ANEKSI NR.5 "Projektet e investimeve".....</i></b>	<b>45</b>
<b>Organet ekzekutive dhe legislative, për çështjet financiare, fiskale dhe për çështjet e jashtme .....</b>	<b>45</b>
<b>Shërbime te pergjithshme .....</b>	<b>45</b>
<b>Shërbimet e Policise .....</b>	<b>46</b>
<b>Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri .....</b>	<b>46</b>
<b>Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia.....</b>	<b>46</b>
<b>Transporti .....</b>	<b>46</b>
<b>Industri te tjera.....</b>	<b>57</b>
<b>Menaxhimi i mbetjeve .....</b>	<b>58</b>
<b>Menaxhimi i ujërave të zeza .....</b>	<b>59</b>
<b>Furnizimi me ujë.....</b>	<b>59</b>
<b>Ndriçimi i rrugëve.....</b>	<b>60</b>
<b>Shërbimet rekerative dhe sportive.....</b>	<b>60</b>
<b>Shërbime kulturore .....</b>	<b>61</b>
<b>Arsimi bazë dhe parashkollor .....</b>	<b>62</b>
<b>Arsimi i mesem .....</b>	<b>66</b>
<b>Sëmundje dhe paaftësi .....</b>	<b>66</b>
<b>Te moshuarit.....</b>	<b>67</b>
<b>Familja dhe fëmijët .....</b>	<b>67</b>
<b>Strehimi dhe komoditetet e komunitetit .....</b>	<b>68</b>

## I. VESHTRIM I PERGJITHSHEM

Bashkia Durres per vitin 2018 ne mbeshtetje te ligjit NR.68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” ka miratuar buxhetin te ndare sipas klasifikimit te ri te Ministrise Financave ne 29 funksione . Nga keto 25 funksione jane te financuara nga Bashkia. Plani fillestar i buxhetit te Bashkise Durres per vitin 2018 i miratuar me VKB nr.469 Dt.23.12.2017 ishte 2.673.045 mije leke. Ky plan me shtesat e fondeve te trasheguara nga viti i meparshem 2017 , si dhe me rialokimet e bera gjate vitit kapi vleren 3.428.671 mije leke . Fonde te celura ne thesar per vitin 2018 rezultojne 2.729.542 mije leke , kurse shpenzimet faktike per vitin 2018 ishin 2.273.019 mije leke.

Ne mije leke

P	Kodi	Buxhet I rishikuar 2018	Plani vjetor Celur ne thesar 2018	Fakt 2018
	<b>Programe/Funksionet buxhetore</b>			
	Organet ekzekutive dhe legjislative etj.	281.350	264.856	243.481
P1	011			
P2	013	78.323	56.867	52.383
P3	031	31.663	31.513	28.158
P4	032	70.642	70.396	64.383
P5	036	3.211	3.211	3.088
P6	041	12.505	12.205	11.918
P7	042	87.301	87.078	76.898
P8	045	752.505	417.735	308.445
P9	047	123.739	95.669	68.856
P10	051	395.240	380.171	363.021
P11	052	8.617	6.610	4.480
P12	053	0	0	0
P13	056	1.875	1.875	1.801
P14	061	0	0	0
P15	062	12.796	12.796	12.391
P16	063	41.580	41.580	41.580
P17	064	110.451	109.148	82.833
P18	072	0	0	0
P19	081	215.560	189.534	180.667
P20	082	110.207	108.212	75.771
P21	091	686.503	475.235	384.535
P22	092	157.912	133.734	75.125
P23	096	4.560	4.560	4.560
P24	101	7.423	7.423	5.775
P25	102	20.298	20.297	18.753
P26	104	137.699	132.106	103.508
P27	105	0	0	0
	Strehimi dhe komoditetet e	61.661	51.201	45.732
P28	106			
	komunitetit			

P29	107	Ndihma ekonomike	15.350	15.350	14.877
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>			<b>3.428.671</b>	<b>2.729.542</b>	<b>2.273.019</b>

**Shenim:** Ketu nuk jane perfshire shpenzimet me fonde nga transferta e kushtezuar dhe nga FZHR , pasi ato nuk jane shpenzime te grupit 00 qe i perket buxhetit vendor, por jane shpenzime me grupe te ndryshme sipas grupi te Ministrive perkatese qe i alokon.

## **II. INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT**

Për të gjitha programet situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë vitit 2018, përfshirë këtu buxhetin fillestar, dhe buxhetin me ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*ne mije leke*

<b>P</b>	<b>Kod i</b>	<b>Programet/funksionet buxhetore</b>	<b>Buxheti fillestar 2018</b>	<b>Buxheti rishikuar 2018</b>	<b>diferenca</b>
			1	2	3 = 2-1
P1	011	Organet ekzekutive dhe legjislativ etj.	263.345	281.350	18.005
P2	013	Sherbime te pergjithshme	57.921	78.323	20.402
P3	031	Shërbimet e Policise	14.629	31.663	17.034
P4	032	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	64.783	70.462	5.679
P5	036	Rendi publik dhe masat e sigurise	3.211	3.211	0
P6	041	Çështjet e përgjith. Ek. treg., punes	12.505	12.205	0
P7	042	Bujqësia, pyjet, peshkimi& gjuetia	71.119	87.301	16.182
P8	045	Transporti	539.418	752.505	213.087
P9	047	Industri te tjera	122.451	123.739	1.288
P10	051	Menaxhimi i mbetjeve	371.681	395.240	23.559
P11	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	10.190	8.617	-1.573
P12	053	Reduktimi i ndotjes	-	-	-
P13	056	Mbrojtja mjedisore	1.875	1.875	0
P14	061	Zhvillimi i strehimit	-	-	-
P15	062	Zhvillimi I komunitetit	12.796	12.796	0
P16	063	Furnizimi me ujë	1.977	41.580	39.603
P17	064	Ndriçimi i rrugëve	104.886	110.451	
P18	072	Shërbimet ambulatorie	-	-	-
P19	081	Shërbimet rekerative dhe sportive	175.994	215.560	39.566
P20	082	Shërbime kulturore	87.161	110.207	23.046

P21	091	Arsimi bazë dhe parashkollor	462.631	686.503	223.872
P22	092	Arsimi i mesëm	112.167	157.912	45.745
P23	096	Shërbimet plotësuese për arsimin	4.560	4.560	0
P24	101	Sëmundje dhe paaftësi	6.889	7.423	534
P25	102	Te moshuarit	15.658	20.298	4.640
P26	104	Familja dhe fëmijët	116.706	137.699	20.993
P27	105	Papunësia	-	-	-
P28	106	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	23.262	61.661	38.399
P29	107	Ndihma ekonomike	15.530	15.350	0
		<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>2.673.045</b>	<b>3.428.671</b>	<b>755.626</b>

Ndryshimet e planit në krahasim me buxhetin fillestar, përgjatë vitit 2018 kanë ndodhur si rrjedhojë e rialokimit të të ardhurave të paalokuara për shpenzime deri në fund të vitit 2017 si dhe fondeve të shpenzimeve papapërdorura në 2017. Në total gjendja e tyre në 31 dhjetor 2017 ishte 714.514 mijë lekë. Sipas ligjit këto fonde janë trashëguar në 2018 dhe janë rishpërndarë sipas planit të miratuar me VKB nr. 488 dt.23/04/2018 . Gjithashtu gjatë vitit me Vendime të keshillit Bashkiak janë bërë ndryshime në buxhet për rialokime fondesh nga fondi rezerve dhe i kontigjencës, apo rialokime fondesh për investime nga kursimet e prokurimeve. Ka patur 13 VKB për rialokime fondesh.

### **III. KARAKTERISTIKA KRYESORE TË PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE**

Për vitin 2018 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me buxhetin, paraqitet si më poshtë:

<b>P</b>	<b>Kod i</b>	<b>Programet/funksionet buxhetore</b>	<b>% e realizimit të totalit të shpenzimeve kundrejt buxhetit 2018</b>
P1	011	Organet ekzekutive dhe legjislativë etj.	86,5
P2	013	Shërbime të përgjithshme	66,9
P3	031	Shërbimet e Policisë	88,9
P4	032	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	91,4
P5	036	Rendi publik dhe masat e sigurisë	96,2
P6	041	Çështjet e përgjith. Ek. treg., punës	97,6

P7	042	Bujqësia, pyjet, peshkimi& gjuetia	88,1
P8	045	Transporti	41
P9	047	Industri te tjera	55,6
P10	051	Menaxhimi i mbetjeve	91,8
P11	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	52
P12	053	Reduktimi i ndotjes	-
P13	056	Mbrojtja mjedisore	96,1
P14	061	Zhvillimi i strehimit	-
P15	062	Zhvillimi I komunitetit	96,8
P16	063	Furnizimi me ujë	100
P17	064	Ndriçimi i rrugëve	75
P18	072	Shërbimet ambulatorë	-
P19	081	Shërbimet rekerative dhe sportive	83,8
P20	082	Shërbime kulturore	68,8
P21	091	Arsimi bazë dhe parashkollor	56
P22	092	Arsimi i mesëm	47,6
P23	096	Shërbimet plotësuese për arsimin	100
P24	101	Sëmundje dhe paaftësi	77,8
P25	102	Te moshuarit	92,4
P26	104	Familja dhe fëmijët	75,2
P27	105	Papunësia	-
P28	106	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	74,2
P29	107	Ndihma ekonomike	95,8
		<b>TOTALI REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE</b>	<b>66,3 %</b>

Pra siç shikohet nga të dhënat e tabelës së mësipërme plani i shpenzimeve të buxhetit në total , për Bashkinë Durrës për vitin 2018 është realizuar në masën 66,3%. Duke e parë këtë realizim sipas programeve, vërejmë që përqindja e realizimit të shpenzimeve varion në nivele të ndryshme duke filluar nga 100 % të planit vjetor në programin “Shërbime plotësuese për arsimin”, deri në 41% në programin “Transporti”.

Sikurse shihet programi me realizim me të ulet është programi i transportit. Këtu futen fondet për mirëmbajtjen , rikonstruksionin , studime-projektme të rrugëve. Në buxhetin e vitit 2018 ky program zë pjesën specifike me të madhe në buxhet , me një plan vjetor prej 752.505 mijë leke, realizuar 308.445 mijë leke. Ky realizim i ulet ka ardhur për shkak të mosrealizimit në kohë brenda vitit 2018 të procedurave të prokurimit të fondeve të investimeve , si dhe të vendosjes së limitit të shpenzimeve cash nga M. Financave për periudhën 12 nëntor – 31 dhjetor 2018. Ky kufizim i ka krijuar ne moslikujdim të situacioneve . Në mënyrë me të detajuar do ta shpjegojmë në aneksin e realizimit të investimeve.

Struktura e shpenzimeve apo pesha specifike e tyre për çdo program sipas buxhetit fillestar, buxhetit të rishikuar për vitin 2018, planit të buxhetit, si dhe realizimit të vitit 2018, paraqiten si më poshtë

P	Kod i	Programet/funksionet buxhetore	Struktura sipas buxhetit fillestar 2018	Struktura sipas buxhetit të rishikuar 2018	Struktura sipas faktit 2018
			1	2	3
P1	011	Organet ekzekutive dhe legjislativë etj.	9,9%	8,2%	10,7%
P2	013	Shërbime të përgjithshme	2,2%	2,3%	2,3%
P3	031	Shërbimet e Policisë	0,5%	0,9%	1,2%
P4	032	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	2,4%	2,1%	2,8%
P5	036	Rendi publik dhe masat e sigurisë	0,1%	0,1%	0,1%
P6	041	Çështjet e përgjith. Ek. treg., punës	0,5%	0,4%	0,5%
P7	042	Bujqësia, pyjet, peshkimi & gjuetia	2,7%	2,5%	3,4%
P8	045	Transporti	20,2%	21,9%	13,6%
P9	047	Industri të tjera	4,6%	3,6%	3,0%
P10	051	Menaxhimi i mbetjeve	13,9%	11,5%	16,0%
P11	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	0,4%	0,3%	0,2%
P12	053	Reduktimi i ndotjes	0	0	0
P13	056	Mbrojtja mjedisore	0,1%	0,15	0,1%
P14	061	Zhvillimi i strehimit	0	0	0
P15	062	Zhvillimi I komunitetit	0,5%	0,4%	0,5%
P16	063	Furnizimi me ujë	0,1%	1,2%	1,8%
P17	064	Ndriçimi i rrugëve	3,9%	3,2%	3,6%
P18	072	Shërbimet ambulatorë	0	0	0
P19	081	Shërbimet rekreative dhe sportive	6,6%	6,3%	7,9%
P20	082	Shërbime kulturore	3,3%	3,2%	3,3%
P21	091	Arsimi bazë dhe parashkollor	17,3%	20%	16,9%
P22	092	Arsimi i mesëm	4,2%	4,6%	3,3%
P23	096	Shërbimet plotësuese për arsimin	0,2%	0,1%	0,2%
P24	101	Sëmundje dhe paaftësi	0,3%	0,2%	0,3%
P25	102	Te moshuarit	0,6%	0,6%	0,8%
P26	104	Familja dhe fëmijët	4,4%	4%	4,6%
P27	105	Papunësia	0	0	0
P28	106	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	0,9%	1,8%	2,0%
P29	107	Ndihma ekonomike	0,6%	0,5%	0,7%
		<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Duke parë strukturën e realizimit të shpenzimeve per vitin 2018, vërejmë që pjesën më të madhe të shpenzimeve faktike e zene shpenzimet e programit te “Arsimit baze dhe prashkollor ” me 16,9%, i dyti renditet programi i menaxhimit te mbetjeve me 16% dhe i treti programi i transportit rrugor me 13,6%.

Sipas zërave përberës të shpenzimeve, korrente e kapitale situata në fund të vitit 2018, paraqitet si me poshtë:

### Shpenzimet korrente

Ne tabelen e mposhteme po japim ne menyre te detajuar realizimin e fondeve per shpenzime korrente sipas programeve :

*ne mije leke*

P	Kod i	Programet /funksionet buxhetore	BUXHET FILLEST AR 2018	BUXHET I RISHIKU AR 2018	PLAN THESARI 2018	FAKT 2018	% e realizi mit kundrejt buxhetit
P1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative etj.	247.162	255.167	255.167	235.482	92,3
P2	013	Sherbime te pergjithshme	47.721	47.721	47.241	42.903	89,9
P3	031	Shërbimet e Policise	14.629	23.263	23.263	19.908	85,6
P4	032	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	59.697	65.121	65.121	59.193	90,9
P5	036	Rendi publik dhe masat e sigurise	3.211	3.211	3.211	3.088	96,2
P6	041	Çështjet e përgjith. Ek. treg., punes	12.205	12.205	12.205	11.918	97,6
P7	042	Bujqësia, pyjet, peshkimi& gjuetia	71.119	80.922	80.699	70.524	87,2
P8	045	Transporti	103.797	110.821	107.208	99.243	89,6
P9	047	Industri te tjera	10.241	10.241	9.741	7.875	76,9
P10	051	Menaxhimi i mbetjeve	363.681	369.369	354.888	337.738	91,4
P11	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	0	0	0	0	0
P12	053	Reduktimi i ndotjes	0	0	0	0	0
P13	056	Mbrojtja mjedisore	1.875	1.875	1.875	1.801	96
P14	061	Zhvillimi i strehimit	0	0	0	0	0
P15	062	Zhvillimi I komunitetit	12.796	12.796	12.796	12.391	96,8
P16	063	Furnizimi me ujë	0	0	0	0	0
P17	064	Ndriçimi i rrugëve	99.793	109.451	109.148	82.833	75,7
P18	072	Shërbimet ambulatorie	0	0	0	0	0
P19	081	Shërbimet rekerative dhe sportive	141.736	149.381	146.330	137.648	92,1
P20	082	Shërbime kulturore	70.648	76.485	76.485	70.779	92,5
P21	091	Arsimi bazë dhe parashkollor	263.203	290.751	285.692	250.884	86,3
P22	092	Arsimi i mesem	61.854	65.731	65.731	54.362	82,7
P23	096	Shërbimet plotesuese për arsimin	4.560	4.560	4.560	4.560	100
P24	101	Sëmundje dhe paaftësi	6.889	6.889	6.889	5.393	78,3
P25	102	Te moshuarit	15.658	15.658	15.658	14.114	90,1

P26	104	Familja dhe fëmijët	93.716	94.541	94.538	81.917	86,6
P27	105	Papunësia	0	0	0	0	0
P28	106	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	9.262	19.961	9.961	6.882	34,5
P29	107	Ndihma ekonomike	15.530	15.530	15.530	14.877	95,8
		<b>TOTALI I SHPENZ. KORRENTE</b>	<b>1.730.983</b>	<b>1.841.650</b>	<b>1.803.935</b>	<b>1.626.313</b>	<b>88,3%</b>

Pra siç shikohet nga të dhënat plani i buxhetit në total për vitin 2018, për shpenzimet korente është realizuar në masën 88,3%. Realizimi më i ulët i shpenzimeve korente paraqitet në programin “strehimi dhe komoditetet e komunitetit”, i cili ka patur një realizim në masën 34,5%. Ky nivel i ulët realizimi në këtë program ka ardhur për shkak të mosperdorimit të fondit prej 10.000 mije leke për subveçionimin e interesave të kredise për strehim, për arsye të mosrealizimit të procedurave përkatëse brenda vitit 2018.

Fondi i **shpenzimeve korente** i detajuar sipas artikujve paraqitet si në tabelë:

*ne mije leke*

Art.	Emertimi	Buxhet fillestar	Buxhet i rishikuar	Plan thesari	Fakt	% e realizimit kundrejt buxhetit
600	<i>Paga</i>	955.058	972.715	951.205	896.847	92,2
601	<i>Sig.shoqerore</i>	152.468	157.221	156.826	149.191	94,9
602	<i>Mallra dhe sherbime</i>	582.576	659.412	649.634	536.048	81,3
603	<i>Subvencione</i>	0	0	0	0	
604	<i>Transferta korente të brendshme</i>	25.139	25.139	25.139	24.132	96
605	<i>Transferta korente të huaja</i>	0	0	0	0	
606	<i>Tranf.per buxh.fam.&amp;indiv.</i>	15.742	27.163	21.131	20.095	74
	<b>TOTALI</b>	<b>1.730.983</b>	<b>1.841.650</b>	<b>1.803.935</b>	<b>1.626.313</b>	<b>88,3</b>

Realizimi i shpenzimeve për paga në masën 92,2% ka ardhur për shkak të mosperdorimit të plotë të fondit të vecantë, si dhe mungesave mbi 15 ditë në sektorin e pastrimit që ka edhe numrin më të

madh te punonjesve. Kjo reflektohet edhe te shpenzimet per sigurime shoqerore , plani i te cilave eshte realizuar ne 94.9%.

Plani i shpenzimeve per mallra e sherbime eshte realizuar ne masen 81.3%. Arsyeja e realizimit ne kete vlere eshte moslikujdimi i faturave per mallra e sherbime per arsye te vendosjes se limitit te shpenzimeve nga MF ne periudhen 12 nentor -31 dhjetor 2018. Vlera e ketyre faturave te palikujduara per mallra e sherbime kapi vleren 78 milion leke. Gjithashtu nje arsye tjeter ka qene edhe kursimet nga prokurimet per kete artikull.

### Shpenzimet kapitale

Ne tabelen e meposhteme po japim ne menyre te detajuar realizimin e fondeve te investimeve sipas programeve :

*ne mije leke*

P	Kod i	Programet/funksionet buxhetore	Buxhet fillestar 2018	Buxhet rishikuar 2018	Plan thesari 2018	Fakt 2018
P1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative etj.	16.183	26.183	9.690	7.999
P2	013	Sherbime te pergjithshme	10.200	30.602	9.626	9.480
P3	031	Shërbimet e Policise	0	8.400	8.250	8.250
P4	032	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	5.086	5.341	5.276	5.190
P5	036	Rendi publik dhe masat e sigurise	0	0	0	0
P6	041	Çështjet e përgjith. Ek. Treg., punes	0	0	0	0
P7	042	Bujqësia, pyjet, peshkimi& gjuetia	0	6.379	6.379	6.374
P8	045	Transporti	435.621	641.684	310.527	209.202
P9	047	Industri te tjera	112.210	113.498	85.928	60.981
P10	051	Menaxhimi I mbetjeve	8.000	25.871	25.283	25.283
P11	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	10.190	8.617	6.610	4.480
P12	053	Reduktimi I ndotjes	0	0	0	0
P13	056	Mbrojtja mjedisore	0	0	0	0
P14	061	Zhvillimi I strehimit	0	0	0	0
P15	062	Zhvillimi I komunitetit	0	0	0	0
P16	063	Furnizimi me ujë	1.977	41.580	41.580	41.580
P17	064	Ndriçimi I rrugëve	5.093	1.000	0	0
P18	072	Shërbimet ambulatorore	0	0	0	0
P19	081	Shërbimet rekerative dhe sportive	34.258	66.179	43.204	43.019
P20	082	Shërbime kulturore	16.513	33.722	31.727	4.992
P21	091	Arsimi bazë dhe parashkollor	199.428	395.752	189.543	133.651
P22	092	Arsimi I mesem	50.313	92.181	68.003	20.763
P23	096	Shërbimet plotesuese për arsimin	0	0	0	0
P24	101	Sëmundje dhe paaftësi	0	534	534	382
P25	102	Te moshuarit	0	4.640	4.639	4.639
P26	104	Familja dhe fëmijët	22.990	43.158	37.568	21.591

P27	105	Papunësia	0	0	0	0
P28	106	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	14.000	41.700	41.240	38.850
P29	107	Ndihma ekonomike	0	0	0	0
		<b>TOTALI I SHPENZ. KAPITALE</b>	<b>942.062</b>	<b>1.587.021</b>	<b>925.607</b>	<b>646.706</b>

P	Kod i	Programet/funksionet buxhetore	% e realizimit të shpenzimeve kapitale kundrejt buxhetit vjetor 2018
P1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative etj.	30,6
P2	013	Shërbime të përgjithshme	31
P3	031	Shërbimet e Policisë	98,2
P4	032	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	97,2
P5	036	Rendi publik dhe masat e sigurisë	-
P6	041	Çështjet e përgjith. Ek. treg., punës	-
P7	042	Bujqësia, pyjet, peshkimi & gjuetia	99,9
P8	045	Transporti	32,6
P9	047	Industri të tjera	53,7
P10	051	Menaxhimi i mbetjeve	97,7
P11	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	52
P12	053	Reduktimi i ndotjes	-
P13	056	Mbrojtja mjedisore	-
P14	061	Zhvillimi i strehimit	-
P15	062	Zhvillimi I komunitetit	-
P16	063	Furnizimi me ujë	100
P17	064	Ndriçimi i rrugëve	0
P18	072	Shërbimet ambulatorë	-
P19	081	Shërbimet rekerative dhe sportive	65
P20	082	Shërbime kulturore	14,8
P21	091	Arsimi bazë dhe parashkollor	33,8
P22	092	Arsimi i mesëm	22,5
P23	096	Shërbimet plotësuese për arsimin	-
P24	101	Sëmundje dhe paafësi	71,5
P25	102	Te moshuarit	100
P26	104	Familja dhe fëmijët	50
P27	105	Papunësia	-
P28	106	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	93,2
P29	107	Ndihma ekonomike	-
		<b>TOTALI I REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE KAPITALE</b>	<b>40,7%</b>

Pra siç shikohet nga të dhënat plani i buxhetit në total për vitin 2018, për shpenzimet kapitale është realizuar në masën 40,7%. Realizimi më i ulët i shpenzimeve kapitale paraqitet në programin “Sherbime kulturore”, i cili ka patur një realizim në masën 14,8%.

Ne buxhetin e vitit 2018 ishin planifikuar për tu realizuar 106 objekte të reja, kurse objekte në proces nga viti 2017 ishin 32 objekte. U kryen procedurat e prokurimit për 86 objekte, 20 objekte nuk u prokuruan.

Objektet e investimeve të listuara për çdo program janë në aneksin nr. 5

#### IV. TREGUESIT FINANCIARE PËR VITIN 2018

		2017	2018	2019	2020	2021
1	Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave					
	Shpenzimet e përgjithshme / Të ardhurat e përgjithshme	75.2%	71.5%	100.0%	100.0%	100.0%
2	Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave					
	Taksat dhe tarifat lokale / Të ardhurat e përgjithshme	38.9%	33.7%	46.1%	45.8%	44.8%
3	Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave					
	Të ardhura nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	48.2%	42%	58.6%	58.1%	56.8%
4	Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve					
	Shpenzimet kapitale / Shpenzimet e përgjithshme	32%	28.5%	36.3%	35.1%	37.5%
5	Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale					
	Shpenzime korrente / Totali shpenzimeve	68%	71.5%	63.7%	64.9%	62.5%
6	Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve					
	Shpenzimet e personelit / Shpenzimet e përgjithshme	45%	46%	42.2%	44.0%	42.3%
7	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave					
		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

8	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
9	Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	11.6%	8.6%	5.6%	4.4%	3.2%
10	Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	4.5%	6.3%	6.1%	6.0%	5.8%

## V. DETYRIMET E PRAPAMBETURA

Ne tabelen me poshte jane paraqitur detyrimet e prapambetura te Bashkise Durrës. **Theksojme se ato perbehen vetem nga detyrimet e pashlyera te trashguara nga ish komunat nga fondet e te ardhurave te veta.** Ketu nuk jane perfshire detyrimet me fonde nga Fondi shqiptar I Zhvillimit dhe buxheti i shtetit te ishkomunave.

Detyrimet e nj.v.q.v (000/lekë)	Totali i detyrimeve te krijuara deri me 1 janar 2018	Totali i detyrimeve te shlyera gjate vitit 2018	Detyrimi i shlyer në %	Detyrimi i mbetur
<b>Vlera Totale</b>	<b>334,178</b>	<b>59,560</b>	<b>18%</b>	<b>274,618</b>
Investimet	133,441	5,000	4%	128,441
TVSH dhe Kosto lokale	0	0		0
Mallra dhe Shërbime	5,274	0		5,274
Vendime Gjyqësore	195,463	54,560	28%	140,903

## VI. FONDET E ZHVILLIMIT TE RAJONEVE

Ne tabelen e meposhteme po japim objektet e e financuara nga Fondi i Zhvillimit te rajoneve

Nr.	KOD PROJEKTI	EMERTIMI I PROJEKTI	VLERE E PROJEKTI	VLERE E KONTRATES	Likujduar 2015-2017	CELUR TOTAL 2018	fakt 2018
1	M990314	Rikualifikim hapësirave në dy anet e rrugës Pavaresia (Loti I)	350,000	228,271	149,735	75,497	75,497
2	M991375	Rivitalizim i sheshit publik për hyrjes portit	585,000	541,835	309,978	0	
3	M991415	Rehabilitimi I sheshit publik pranë Mazoleumit Faza I	399,811	335,349	Anulluar	0	
4	M991462	Modernizimi I shërbimit të informimit të qytetarëve nëpërmjet dixhitalizimit dhe standartizimit të të dhënave gjeohapsinore të titujve të pronësive dhe B.Durres	15,000	14,700	12,000	2,700	2,700
5	M991510	Rikualifikim hapësirave midis kuartallit nga rruga "Skenderbej" deri në rrugën "Mars 91" e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemim i ujërave të bardha deri tek Ura e Dajlanit, faza I	120,000	108,364	0	76,692	76,691
6	M991523	Rikualifikim hapësirave midis kuartallit nga rruga "Skenderbej" deri në rrugën "Mars 91" e hapësira deri tek rruga e Portit, loti II	107,495	73,730	0	36,865	36,865
7	M112642	Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Marie Kkaculini		103,318	37,058	66,260	66,255
8	M112708	Rikonstruksion dhe shtesë anësore dhe palester e re në shkollën 14 nëntori		78,872	33,312	45,561	45,559
9	M112753	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Armath, NJA Manez (30% bashkia, 70% FZHR)	57,454	28,288	0	9,087	

10	M112754	Rikonceptim dhe rikonstrukcion i shkolles se muzikes Jan Kukuzeli (30% Bashkia , 70% FZHR)	263,612	131,640	0	53,529	
11		Ndertim i shkolles 9 vjecare Jusuf Puka (30% bashkia , 70% FZHR)	140,000				
		<b>Totali</b>		<b>1,644,370</b>	542,083	312,716	<b>303,568</b>
		<b>total FZHR per arsimin</b>				<b>120,962</b>	<b>111,814</b>
		<b>total fshzh</b>				<b>191,754</b>	<b>191,753</b>

## **ANEKS 1. REALIZIMI TE ARDHURAVE PER VITIN 2018**

*Per vitin 2018 te ardhurat e pergjithshme rezultojne : 3,177,044 MIJE LEKE*

Keto te ardhura ne menyre me te detajuar paraqiten ne tabelen e meposhteme:

000/leke

	<b>TE ARDHURAT E PERGJITHSHME</b>	<b>Fakt 2018</b>
	Te ardhurat e veta nga taksat e tarifat	1.336.212
	Transferta e pakushtezuar	782,972
	Transferta specifike	343,245
	Fonde te trasheguara nga viti meparshem	714,515
	<b>TOTALI</b>	<b>3,177,044</b>

Per vitin fiskal 2018 u miratua plani vjetor me vlere **1.596.827.000** leke. Duke u nisur nga ky planifikim, Bashkia Durres punoi maksimalisht per arritjen e ketyre te ardhurave, duke u fokusuar dhe duke u perqendruar shume ne prioritet e saj dhe duke analizuar kohe pas kohe faktoret negative ne segmentet e riskuara qe ndikonin ne mos realizimin e te ardhurave, te cilet kishin efekt negativ ne arritjen ne menyre korrekte te objektivave te vitit 2018, por ne asnje moment nuk anashkaloi bashkepunimin me subjektet dhe qytetaret.


Ne fund te vitit fiskal 2018 u realizuan **1.336.211.909** leke, ose e shprehur ne perqindje, Bashkia Durres realizoi **84%** te planit buxhetor te parashikuar, si dhe duke e krahasuar me faktin 2017, me nje vit paraardhes, ajo realizoi **28.528.447** leke me pak ne vlere monetare, ose **2%** me pak te ardhura se ne vitin 2017 .

Te ardhurat e pushtetit vendor perbehen nga : te ardhurat tatimore dhe te ardhurat jotatimore.

#### **Te ardhura tatimore.**

Per vitin fiskal 2018 keto te ardhura arriten ne shumen **875.089.342 leke** , duke realizuar **93%** te planifikimit vjetor 2018, qe ishte **945.550.000** leke, ose **92.362.577** leke me pak se fakti i viti 2017, i cili ishte **967.451.919 leke**.


Ne kete grup te ardhurash, peshen kryesore specifike e ze “Taksa e Pasurise” me nje realizim te ardhurash rreth **312.989.172 leke**, “ Taksa e Ndikimit ne Infrastrukture” qe realizoi rreth **234.019.017 leke**, si dhe zeri” Taksa te administrimit nga agjentet tatimore” qe arriti vleren **264.692.230 leke** ne fund te vitit fiskal 2018 . Me poshte do te analizohen ne menyre analitike te gjitha taksat respektive qe ndikuan si ne arrijten e te ardhurave tatimore, ashtu dhe ne mos realizimin e tyre.



Grafiku – Te ardhurat tatimore 2017-2018

## ✚ Te ardhura jo tatimore.

Te ardhurat jo tatimore per vitin fiskal 2018 arriten vleren **461.122.567 leke**, duke realizuar **71%** te planifikimit te vitit 2018, dhe duke u krahasuar me vitin paraardhes fiskal 2017 u realizuan **63.834.130 leke** me shume se fakti 2017, i cili arriti shumen **397.288.437 leke**. Tarifat qe ndikuan shume ne te ardhurat jo tatimore jane “Tarifa e pastrimit dhe largimit nga mbeturinat” e cila per vitin fiskal 2018, realizoi nje vlere prej **165.847.592 leke**, “ Tarifa e sherbimeve administrative” realizoi vleren **107.990.472 leke**, “Tarifa e ndricimit” **37.244.545 leke**.



Grafiku – Te ardhurat jotatimore 2017-2018

Me poshte po japim ecurine e realizimit te te ardhurave te Bashkise Durres per periudhen 2014-2018 . Vihet re qe ne vitin fiskal 2018 kemi nje ulje te te ardhurave vjetore te faktit krahasuar me vitin fiskal 2017.

*Te ardhurat per periudhen 2014-2018 paraqiten si me poshte:*

Ne 000/leke

Emertimi	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016	Fakti 2017	Fakti 2018
----------	------------	------------	------------	------------	------------


Ardh:Tatimore	644.284	753.055	843.758	967.452	875.089
Ardh.Jo.tatim	238.754	286.270	391.228	397.288	461.122
<b>Totali</b>	<b>883.038</b>	<b>1.039.407</b>	<b>1.234.986</b>	<b>1.364.740</b>	<b>1.336.211</b>

Sic shihet nga tabela kemi ulje te te ardhurave ne total ne masen 2% nga viti 2017 ne vitin 2018 .

Si paraqitet dinamika e subjekteve qe kryejne aktivitet ne territorin e Bashkise Durrës:

Gjate vitit fiskal 2018 ne sistemin e Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore eshte kjo e dhene ne lidhje me numrin e aktiviteve te regjistruara aktive, fakt mbi te cilin jane realizuar te ardhurat per zerin “biznes”. Tabela e meposhteme paraqet nje informacion mbi strukturen e numrit te subjekteve aktive , ne fund te vitit fiskal 2018.

Lloji i biznesit	Nr. Sub/aktive/tot	Nr. Sub/aktive/tot
	2017	2018
BV	8025	8235
BM	3170	3364
Ambulant	899	958
Transport	972	953
<b>TOTALI</b>	<b>13066</b>	<b>13510</b>



*Grafiku - Struktura e subjekteve Aktiv Krahasimi 2017-2018*

Sic shihet kemi nje rritje te numrit te bizneseve prej 3% ose 444 subjekte me shume ne krahasim me vitin fiskal 2017.

## TE ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

### Taksa mbi Pasurine

Taksas mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjithë personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, pronare apo perdorues te pasurive te mesiperme, ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre pasurive. Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin per taksen mbi pasurine e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkepronari, sipas pjeses qe zoteron, apo perdoruesi i pasurise se paluajtshme, per pasurite qe nuk jane te pajisura me dokumente pronesie. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nese pasuria e taksueshme krijohet, tjetersohet ose zhduket brenda kesaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetem per periudhen e te drejtes se pronesise.


Keshilli i Ministrave miraton metodologjine per percaktimin e vleres se tatueshme te pasurise se paluajtshme – ndertesa, referuar Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 132, date 7.3.2018 Per

metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ndertesa”, e bazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e bazes se takses, si dhe te kriterëve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses.

Kjo takse Bazohet ne ligjin Nr- 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar Ligji nr.106/2017 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9632, date 30.10.2006, per sistemin e taksave vendore”, te ndryshuar.

Keto ndryshime paten influence negative ne buxhetin e bashkise Durrës per vitin fiskal 2018 gje qe do te influençoje negativisht per shkak te peshes te saj me te madhe specifike dhe per buxhetin e vitit 2019. Kjo takse per nga rendesia ,eshte nje nga prioritetet e Bashkise, si per menaxhimin ashtu edhe per vjeljen e saj, si per kategorine “Ndertesa Biznesi“,ashtu dhe per kategorine “Ndertesa per Popullaten”, ku per vjeljen e kesaj te fundit eshte caktuar si agjent tatimor, ndermarrja e” Ujesjelles Kanalizimeve Durrës. Si rezultat i futjes se pagesave te takses se popullates ne faturen e ujit ne vitin fiskal 2018 nga kjo takse jane vjelur rreth **42,549,434 leke** , nderkohe, nga kjo takse te vitit 2017 jane vjelur rreth **31.328.558 leke**. Realizimi i kesaj takse per vitin fiskal 2018 arriti **38%** te planit , ndersa krahasuar me faktin 2017, kjo takse u rrit me nje vlere prej **11.220.876 leke**.

Mos realizimi i kesaj takse ne raport me numrin e familjeve, vjen per arsye objektive sepse ne qytetin e Durrës eshte teper i ndjeshem fenomeni emigrimit si dhe mos jetesa e shume familjeve ne kete qytet per gjate gjithë vitit, ose e thene ndryshe fenomeni sezonal, gje e cila rrit vleren e pritshmerise te te ardhurave ne planifikim, pasi jane pjese e gjendjes civile ne kete qytet, nga ku ne mbeshtetemi per te planifikuar te ardhurat per kete ze. Pra ne planifikimet e fillim vitit ne i referohemi te dhenave te marra nga sistemi informatik i Drejtorise se Gjendjes Civile , per qytetin e Durrës, por qe keto te dhena nuk jane ne sinkron si me rregjistrat e ZRPP-se ashtu dhe me sistemin informatik te ndermarjes se Ujesjelles-Kanalizimeve. Po punohet nga ana jone per perputhjen e listave te sistemit informatik te gjendjes civile me listat faktike te sistemit informatik te ndermarjes ujesjelles kanalizime qe sherben si agjent tatimor per ne,veprim ky qe do te sjelle nje rritje te ndjeshme te ketyre te ardhurave ne vitet ne vijim.




*Grafiku – Te ardhurat nga taksa e pasurise popullate 2017-2018*

### **Taksa e Pasurise nga Biznesi**

Kjo takse per specifiken e saj, eshte shume e lidhur me ndertimet e reja ne qytetin e Durresit si dhe pershtatshmerine qe i behet pronave per ti dhene me qera ne sherbim te aktivite ekonomike. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore arriti qe per vitin fiskal 2018 te ardhurat per kete ze te arrijne vleren **237,360,027 leke**, duke realizuar ne masen 104% te planifikimit vjetor.

Keto te ardhura jane ulur ne krahasim me vitin 2017 sepse gjate ketij vitit hyri ne fuqi Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 132, date 7.3.2018 Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ndertesa”, e bazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e bazes se takses, si dhe te kriterave dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses, sipas te ciles Taksa e Pasurise per bizneset pesoje nje ulje prej 22% por megjithate si rezultat i menaxhimit me te mire te mbledhjes se te ardhurave u be e mundur te jkalimi i planit me 4 % ose 9.860.027 leke me shume.



Grafiku – Te ardhurat nga taksa e pasurise biznese 2017-2018

#### Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Çdo subjekt, i cili kryen nje biznes, me ane te te cilit realizohet gjate vitit fiskal qarkullim me i vogel ose i barabarte me 8 000 000 (tete milione) leke, i nenshtrohet detyrimit te pageses se tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel.

Baza e takses/tatimi: Kestet e parapagimit te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, per vitin vijues, per tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pese) deri ne 8 (tete) milione leke, llogariten ne baze te te dhenave te deklarates tatimore te nje viti me pare. Forma dhe permbajtja e deklarates tatimore vjetore percaktohen me udhezim te Ministrit te Financave.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel paraqiten si me poshte:

Tabele 2. Nivelet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Shkalla tatimore	Njesia	Niveli Ligjor/Detyrimi	
		NjA Durres	NjA te tjera
Me qarkullim vjetor nga 0 – 5.000.000 leke	leke/vit	0	0
Me qarkullim vjetor nga 5.000.001 – 8.000.000 leke	leke/vit	5% e fitimit	5% e fitimit

Kjo takse bazohet ne ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, Ndryshuar me Ligj Nr. 181/2013, date 28.12.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 203, date 30.12.2013.

Menyra e pageses:Tatimpaguesi paguan, ne llogarine e organeve tatimore ose ne Posten Shqiptare, keset tremujore te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, te biznesit te vogel, brenda dates 20 prill, per muajt: janar, shkurt e mars; brenda dates 20 korrik, per muajt: prill, maj e qershor; brenda dates 20 tetor, per muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda dates 20 dhjetor, per muajt: tetor, nentor dhe dhjetor.

Strukturat pergjegjese per vjeljen e taksas/tatimit:Drejtoria Rajonale Tatimore, ne rolin e agentit tatimor, eshte e ngarkuar me vleresimin, mbledhjen, kontrollin, arketimin dhe transferimin ne llogarite e buxhetit te qeverisjes vendore te te ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.

Per kete sherbim Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durres perfiton nje komision prej 1 % te te ardhurave te mbledhura.

Gjate vitit fiskal 2018 kjo takse u menaxhua nga Drejtoria Tatimore Durres e cila realizoi shumen **30.306.142 leke**. Planifikimi per kete ze ishte 55.000.000 leke , pra u realizua 55 % e saj.



Grafiku – Te ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogel 2017-2018

### Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme.

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset per ndertesat dhe

te gjitha pasurite e paluajtshme ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesisë mbi to.

Agjenti tatimor per vjeljen e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesisë per pasurite e paluajtshme eshte Zyra Vendore e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme e cila ne rolin e agjentit te takses perfiton 3 % te shumes se arketuar.

Fakti i vitit fiskal 2018 ka regjistruar shumen **137.199.957 leke** te arketuar nga kjo takse, kundrejt nje planifikimi prej 128.000.000 leke, pra ka arritur nje realizim prej 107 % te planifikimit.

Ky tregues ndiqet rregullisht nga strukturat e DTTV, pune e cila reflektohet ne akt-rakorimet mujore me kete agjent dhe qe konfirmohet edhe nga Dega e Thesarit.



Grafiku – Te ardhurat nga taksa e kalimit te drejtes se pronesisë P.P. 2017-2018

### Taksa e Mjeteve te perdorura

Baza e takses: eshte lloji i mjetit te transportit rrugor

Strukturat pergjegjese per vjeljet e takses: Struktura e mbledhjes se kesaj takse eshte Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor, para kryerjes se kontrollit teknik vjetor te detyrueshem te mjetit. Bazuar ne numrin e mjeteve te regjistruara sipas njesive te qeverisjes vendore, tetembedhete perqind (18%) te te ardhurave vjetore nga kjo takse i kalon perkatesisht Bashkise Durres ne llogarine e deges se thesarit.

Kjo takse bazohet ne ligjin nr. 9975, date 28.07.2008 “Per taksat kombetare” i ndryshuar.

Per vitin fiskal 2018 nga Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor jane arketuar **127.428.285 leke** perkundrejt 80.000.000 leke, te planifikuara per kete vit me nje realizim prej **159%** kundrejt planifikimit .



*Grafiku – Te ardhurat nga taksa e mjeteve te perdorura 2017-2018*

#### Taksa e Tabeles per qellime identifikimi

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emertimin e subjektit në pamjen ballore të njesisë ku zhvillojnë veprimtarinë.


Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Nga kjo takse u realizua një ardhur prej **10.305.893 leke**, nga **28.570.030 leke** që ishte për vitin 2017.

#### Taksa e Tabeles per qellime reklamimi

Kjo takse aplikohet mbi të gjitha subjektet të cilët shfrytëzojnë hapsirat për të reklamuar produkte dhe shërbime të cilat lidhen me aktivitetin që kryejnë.

Të ardhurat nga kjo takse për vitin fiskal 2018 arritën vlerën prej **8.523.225 leke**. Planifikimi i kësaj takse është bërë duke u nisur nga sipërfaqet e reklamave që firmat reklamuese kanë vendosur në qytetin e Durrësit dhe niveleve të përcaktuara në ligj.

**Planifikimi per vitin 2018 te mara se bashku taksat e tabelave ishte 15.500.000 leke , per vitin 2018 jane realizuar 18.829.118 leke ose 121% .**



*Grafiku – Te ardhurat nga taksa e tabelave identifikuese dhe reklamuese 2017-2018*

#### **Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja.**

Baza e taksës është vlera në leke e investimit të ri që kërkohej të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat perkatese percaktohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per dhenien e lejes se ndertimit.

Struktura e ngarkuar per llogaritjen dhe leshimin e autorizimit per pagesen e taksës se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës.

Realizimi i të ardhurave nga kjo takse e ka bazën në të ardhurat që realizohen nga pagesa për zbardhjen e lejeve të ndertimit të miratuara nga K.RR.T-ja pranë Bashkisë së Durrësit në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave në qytetin e Durrësit” dhe kërkesave të subjekteve për leje ndertimi. Per vitin 2018 kjo takse u realizua ne masen **234.019.017 leke**, ose 91% te planifikimit prej 257.270.000 leke, ku nje vend kryesor zene te ardhurat nga Ndertimet e Reja te cilat per kete vit fiskal u realizuan ne masen 180.895.380 leke ose krahasuar me vitin 2017 ku kjo takse u realizua ne vleren 229.188.793 leke ose 48.293.413 leke me pak.

Ulja e te ardhurave nga kjo takse vjen si rezultat i pakesimit te lejeve te ndertimit dhe lejeve te legalizimeve.



*Grafiku – Te ardhurat nga taksa e ndikimit ne infrastrukture 2017-2018*

### **Taksa e Fjeties ne Hotel.**

“Baza e takses se fjetjes ne hotel eshte numri i neteve te qendruara ne hotel”.

“Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim i nivelit te takses se vendosur nga Bashkia, per nate qendrimi, me numrin e neteve te qendrimit ne hotel”.

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e kesaj takse eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore prane Bashkise Durres.

Te ardhurat nga kjo takse per vitin 2018 arriten shifren **14.253.663 leke** , ose 213% te planifikimit te saj prej 6.700.000 leke. Krahasuar me vitin fiskal 2017 kemi nje rritje te kesaj te ardhure me **2.854.390 leke** me shume. Ne kete tejkallim ndikim ka patur menaxhimi me i mire ne drejtim te luftes kunder informalitetit.

Taksa e fjetes ne hotel vazhdon ende te jete nje takse me problematiken e saj specifike, pasi ka ende me shume pune per te ulur informalitetin e hoteleve sezonale apo “ dhoma me qera”, nepermjet rritjes se bashkepunimit me Drejtorine Tatimore dhe strukturat e tjera te pushtetit vendor.

## TË ARDHURA NGA TAKSA E FJETJES NË HOTEL



*Grafiku – Te ardhurat nga taksa e fjetjes ne hotel 2017-2018*

### TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

#### Tarifa e gjelberimit


Tarifa , paguhet nga te gjithë familjet, personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, qe banojne ose ushtrojne veprimtari ekonomike brenda territorit te Bashkise se Durresit. Kjo tarife eshte vjetore dhe likuidimi i saj detyrimisht behet brenda 20 Prillit te çdo viti.

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e tarifes se gjelberimit nga subjektet eshte Drejtoria e Taksave Tarifave Vendoredhe Drejtoria e Urbanistikes per subjektet qe marrin leje ndertimi.

Agjenti tatimor per mbledhjen e tarifes se gjelberimit per kategorine e familjareve eshte Ndermarja e Ujesjelles Kanalizimeve Durres.

Realizimi i tarifes se gjelberimit per vitin fiskal 2018, eshte si me poshte vijon:

Nga kategoria biznesit u realizua nje vlere prej **29.609.122 leke**, rreth 75 % te planifikimit prej 39.300.000 leke. Nese do te krahasojme realizimin e faktit te viti 2018 me vitin fiskal 2017 kemi nje ritje prej 5% te te ardhurave nga ky ze,ose rreth 1.531.716 leke me shume pasi ne vitin fiskal 2017 u realizuan 28.077.406 leke.



Grafiku – Te ardhurat nga tarifa e gjëlberimit nga bizneset dhe familjet 2017-2018

Nga kategoria familjare u realizua vlera 3.580.791 leke, ose 40% te planifikimit prej 9.000.000 leke. Mos realizimi i kesaj tarife ne menyre te ndjeshme vjen vetem nga fakti qe kemi nje planifikim buxhetor teper te larte per shkak te numrit te madh te familjareve te regjistruar ne sistemin e Gjendjes Civile te rrethit Durres dhe faktit qe ky realitet nuk eshte pasi shume familje vertet jane te regjistruar, por nuk jetojne ne kete qytet , ose jetojne vetem per disa dite ose muaj (sezonale). Pra kemi nje dispropocion midis faktit te sistemit te Gjendjes Civile dhe faktit real te familjeve qe jetojne ne qytetin e Durresit.

#### Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave.


Tarifes se pastrimit dhe largimit te mbeturinave i nenshtrohen te gjithë : familjet, personat fizike e juridike, vendas e te huaj, te cilet banojne dhe ushtrojne veprimtari ekonomike brenda territorit te qytetit te Durresit.

Agjentet per mbledhjen e tarifes se pastrimit dhe largimit te mbeturinave per familjaret per vitin 2017 jane Drejtoria e Ujesjelles – Kanalizemeve , per te gjithë subjektet e tjera struktura e ngarkuar per mbledhjen e kesaj tarife eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikes per subjektet qe marrin leje ndertimi.

Realizimi per” Tarifen e pastrimit dhe largimit te mbeturinave”per vitin 2018 eshte **165.847.592 leke** ose 14,771,731 leke me shume se ne vitin 2017, ku realizimi i kesaj tarife ka qene 151,075,861 leke. Ky ze ka ne perberjen e tij:


“Tarifen e pastrimit dhe largimit te mbeturinave nga biznesi”qe ne vitin 2018 eshte realizuar ne masen 123,023,444 leke ose 81% te planifikimit. Per vitin 2017 realizimi i kesaj tarife ishte prej

120,644,025 leke. Ne krahasim me vitin 2017 kjo tarife eshte rritur ne masen 2% te te ardhurave apo ne vlere prej 2,379,419 leke.



*Grafiku – Te ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave nga bizneset 2017-2018*

“ Tarifen e pastrimit dhe largimit te mbeturinave nga popullata” ne vitin 2018 eshte arritur vlere prej 42.824.148 leke, rreth 41% e planifikimit prej 104.000.000 leke. Ky mosrealizim vjen perseri nga te njetat argumenta qe kemi permendur me siper, kemi nje rritje prej 12.392.312 leke apo prej 41% me shume te ardhura, kundrejt vitit 2017, vit ne te cilen kjo tarife u realizua ne vleren 30,431,836 leke.



Grafiku – Te ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave nga familjet 2017-2018

### Tarife e zenies se hapsires publike.

Baza e tarifes per zenie te hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup>, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim i taksapaguesit.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbehet prej:

- Tarifa për zënien e hapësirave publike Spektakle ose panairë të ndryshme
- Tarifa për zënien e hapësirave publike (Përdorim i truallit për tavolinë)
- Tarifa për zënien e hapësirave publike me mallra jashtë vendit të tregtimit
- Tarifa për zënien e hapësirave publike me platformë me kangjella vazo drurë dekorativ etj;

Për vitin 2018 parashikohet që Tarifa e zënies së hapësirave publike për veprimtari të ndryshme të ishte 1.500.000 leke, nga e cila u realizuan 1.486.967 leke rreth 99% e saj dhe për Tarifa e zënies së hapësirave për tavolinë u parashikua për vitin fiskal 2018, rreth 8.000.000 leke dhe u realizua në vlerën prej 6.130.123 leke.

### Tarifa e zenies se hapsires publike per treg

Kesaj takse i nënshtrohen të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregjet publike në administrim të Bashkisë Durrës.

Baza e kesaj Tarife është sipërfaqja në m<sup>2</sup> për tregtimin e artikujve të ndryshëm dhe kjo takse llogaritet si detyrim i taksapaguesit.


Te ardhurat nga kjo Tarife per vitin 2018 ishin planifikuar ne vleren 12.500.000 leke dhe e ardhura nga kjo takse arriti ne vleren **12.399.700 leke**, rreth 99% te planifikimit.

### Tarifa e plazheve Private

Kjo tarife aplikohet mbi te gjithë subjektet qe shfrytezojne siperfaqen e reres ne vijen bregdetare per plazhe private gjate periudhes se sezonit turistik.

Te ardhurat nga kjo tarife per vitin fiskal 2018 jane realizuar ne shumen **41.013.170 leke**, realizim prej 117% te planifikimit vjetor. Gjate vitit fiskal 2017 u realizua shuma prej 32.195.400 leke, pra krahasuar me faktin e vitit 2017 , kemi nje rritje rreth 8.817.770 leke me shume.

Kjo ka ardhur si rezultat i nje menaxhimi me te mire nga strukturat e D.T.T.V dhe Policia Bashkiake.



Grafiku – Te ardhurat nga tarifa e plazheve private 2017-2018

### Tarifa e parkimit.

Ne parashikimin e kesaj te ardhure jane marre ne konsiderate si te ardhurat qe vilen nga Drejtoria e Sherbimeve ashtu edhe nga te ardhurat qe vilen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Realizimi i kesaj tarife per vitin fiskal 2018 eshte 22.050.098 leke, realizim prej 88% te planifikimit ne vleren 25.000.000 leke. Krahasuar me faktin e te ardhurave per vitin fiskal 2017,

kemi nje realizim 9 % me pak se te ardhurat ne vitin 2017,dhe nje ulje negative prej 2.158.474 leke. Ne vitin 2017 ky tregues u realizua ne shumen 24.208.572 leke.

### Tarifa e ndricimit


Objekt i kesaj tarife do te jene te gjithë familjet, personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, qe banojne ose ushtrojne veprimtari ekonomike brenda territorit te Bashkise se Durrësit.

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e tarifës se ndricimit nga subjektet eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Agjenti tatimor per mbledhjen tarifës se ndricimit per kategoria e familjareve eshte Drejtoria Ujesjelles – Kanalizimeve.


Nisur nga rezultatet e deritanishme, per vitin fiskal 2018 u realizuan te ardhurat :

“ Tarifa e ndricimit per bizneset” arriti vleren prej **27.980.492 leke**, ose 64% te planifikimit vjetor prej 44.000.000 leke. Edhe ne kete tarife kemi perseri renie te ardhurash, ne krahasim me faktin e vitit 2017 i cili u realizua ne vleren 28.630.611 leke.Ne vitin 2018 kemi nje realizim prej rreth 2% me pak te ardhura, ose 650.119 leke, ne krahasim me vitin fiskal 2017.



Grafiku – Te ardhurat nga tarifa e ndricimit nga biznesi 2017-2018

“Tarifa e ndricimit per familjet”,arriti vleren prej 9,264,053 leke, ose 42% te planifikimit. Perseri edhe ketu, logjikisht, eshte ndjeshem po i njeti risk , sic ka ndodhur edhe ne tarifate tjera te popullates. Por kemi nje rritje te konsiderueshme ne vitin 2018 ne krahasim me faktin e viti 2017, e cila kap vleren prej 2,463,964 leke ose 36% me shume .



*Grafiku – Te ardhurat nga tarifa e ndricimit nga familjet 2017-2018*

### **Tarifa e transportit publik**

Kjo tarife perlogaritet nga Drejtoria e Sherbimeve dhe realizimi i kesaj te ardhure per vitin 2018 eshte 5.467.665 leke, realizim 119% te planifikimit per kete vit. Krahasuar me vitin 2017 gjate vitit 2018 kemi nje rritje prej 179.360 leke ose 3.4% me shume.

### **Tarifa e sherbimimeve administrative**

Kjo tarife perlogaritet nga Drejtoria e Sherbimeve dhe realizimi i kesaj te ardhure per vitin 2018 eshte 16.948.011 leke ose 249% te planifikimit vjetor. Ne vitin 2017 kjo tarife u realizua ne vleren 2.372.200 leke. Ne vitin 2018 kemi nje rritje prej 14.575.811 leke me shume te ardhura nga kjo tarife .

### **Tarifa e Urbanistikës**

Kjo tarife per vitin 2018 u planifikua ne vleren 1.500.000 leke per sherbimet qe iu ofrohen firmave ndertuese. Nga kjo tarife u realizuan te ardhura me vleren prej 1.788.138 leke, ne krahasim me realizimin e vitit 2017, ne vitin 2018 kemi nje ulje prej 1.632.104 leke. Kjo tarife llogaritet dhe mblidhet nga Drejtoria e Urbanistikës.

### **Te ardhura te tjera**

Me poshte te ardhurat jane te detajuara sipas zerave :

